

Celebrime

Në Ambasadën Shqiptare mund të kryhen martesë/celebrime vetëm midis dy shtetasve shqiptarë.

Për të bërë celebrimin në Ambasadë, është e nevojshme të njoftohet më parë shpallja për lidhje martesë në Shqipëri. Kërkesa për shpallje martesë bëhet nga bashkëshortët e ardhshëm ose nga personi i caktuar nga ata me prokurë të posaçme në zyrën e gjendjes civile të vendbanimit të nuses dhe dhëndrit në Shqipëri.

Prokurë për shpalljen e martesës

Në rastet kur shtetasit shqiptarë nuk kanë mundësi të paraqiten në gjendjen e tyre civile në Shqipëri, duhet të paraqiten në Ambasadën Shqiptare për të autorizuar me prokurë të posaçme një person në Shqipëri, i cili do të kryejë veprimet e nevojshme për shpalljen e martesës dhe tërheqjen e certifikatave.

Për tu celebruar pranë Zyrës Konsullore duhet njëri nga të dy bashkëshortët e ardhshëm të ketë kryer paraprakisht aplikimin elektronik në e-albania.

Për më tepër informacion, lutemi klikoni në linkun si më poshtë:

https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=9776

Dokumentacioni i nevojshëm për secilin nga bashkëshortët e ardhshëm:

- Certifikatë Lindje, modeli ndërkombëtar, e tre mujorit të fundit
- Certifikatë për Lidhje Martese modeli ndërkombëtar, e tre mujorit të fundit
- Leje qëndrimi ose konfirmim e qëndrimit të ligjshëm në Greqi
- Pasaportat biometrike dhe Letërnjoftim ID (Kartë Identiteti)
- Dy dëshmitarë, me pasaportat ose Letërnjoftimet ID (Kartë Identiteti)

Dëshmitarët duhet të jenë shtetas shqiptarë dhe nuk duhet të jenë pjesëtarë të familjes ekzistuese të bashkëshortëve të ardhshëm.

Me numrin e aplikimit të nxjerrë nga e-albania bashkëshortët e ardhshëm duhet të paraqiten në përfaqësi për të kryer Aktin e Martesës.

Tarifa e shërbimit

Tarifa konsullore për lidhje martesë është 30 euro . Pagesa mund të kryhet me çdo lloj kartë bankare nëpërmjet aparaturave POS të instaluar në Zyrën tonë Konsullore ose me kartëmonedha (CASH) në bankomatit pranë Ambasadës, të përshtatur në gjuhën shqipe.

Periudha e vlefshmëria

Kohëzgjatja e rregjistrimit në Z.GJ.C. në Shqipëri mund të zgjasë deri në tre (3) muaj.

- Konsulli mund ti lëshojë të interesuarit dublikatë të aktit të martesës ose vërtetim certifikatë martese.
- Lidhja martesore kryhet nëse ligji i vendit pritës nuk e ndalon.
- Lidhja martesore kryhet nëse nuk është në kundërshtim me Marrëveshjen dypalëshe nëse ekziston midis dy vendeve.

Në rastin e martesës midis një shtetasi shqiptar dhe një shtetasi grek, martesa kryhet vetëm në Zyrën e Gjendjes Civile në Shqipëri ose në Bashkinë greke (Dhimo).

Sqarojmë se për çdo informacion të interesuarit duhet të kontaktojnë me Ambasadën Shqiptare për dokumentacionin paraprak në numrin e telefonit 210.6876213

Për çdo paqartësi mos hezitoni të na kontaktoni në adresën tonë të e-mail-it consulate.athens@mfa.gov.al.